



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

V E N D I M

Nr. 36, Datë 17/04/2020

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 122, datë 27.09.2019, e Z. E.C., ku pretendohet diskriminim për shkak të “*përkatësisë në një grup të veçantë*”¹, nga ana e Intesa San Paolo Bank Albania sh.a..

Pas shqyrtimit përfundimtar të ankesës së mësipërme, Komisioneri²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas ankuesit.

Z. E.C. ka qenë ish-punonjës i ish-Bankës Veneto sh.a. në Shqipëri, që pas shkrirjes me Intesa San Paolo Bank Albania sh.a., u largua nga puna si pasojë e procesit të ristrukturimit. Ankuesi shprehet se në muajin qershor 2017, qeveria italiane shpalli falimentimin e Grupit Veneto Banca, nga ku u vendos që Intesa San Paolo Bank Spa të përthithte pjesën e cilësuar si “*good bank*” të ish-Veneto Bank, e cila konsistonte në pjesën e performancës së mirë të bankave të këtij grupi, kapitalet, financimet, depozitat, asetet, hipotekat etj. Referuar informacionit të depozituar në cilësi prove rezulton se punonjësve të Veneto Banka sh.a. u janë dhënë 2 (dy) zgjidhje, ku e para konsiston në fillimin e procedurave për zgjidhjen e kontratës së punës, si pasojë e pushimit kolektiv dhe opsioni i dytë konsiston në nënshkrimin e Marrëveshjes Reciproke për Përfundimin e Kontratës së Punës.

Ankuesi ka zgjedhur opsionin e dytë duke nënshkruar Marrëveshjen e sipërpërmendur. Z. E.C. ishte kredimarrës pranë Veneto Bank. Në bazë të pikës 5, të Marrëveshjes Reciproke të lidhur ndërmjet Veneto Bank/Intesa San Paolo Bank dhe ankuesit, parashikohet se për punonjësit, që janë subjekt i pushimit kolektiv, të cilët do të nëshkruajnë marrëveshjen, ISPB do të aplikojë për

¹ Grupi i veçantë përbëhet nga të gjithë ish-punonjësit e ish-Veneto Bank, të cilët kanë nënshkruar Marrëveshjen Reciproke me ISPA dhe kreditë, e të cilëve nuk u janë nënshtruar parashikimit të nenit 5, të kësaj Marrëveshjeje.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

kreditë ekzistuese termat dhe kushtet preferenciale, që aktualisht janë në fuqi për stafin e ISBA-së. Marrëveshja është lidhur në datën 15.09.2018 dhe ka hyrë në fuqi në datën 19.10.2018.

Pas falimentimit të Veneto Bank, ankuesi shprehet se është vënë në dijeni të faktit, që kredia e tij është konsideruar si “kredi e keqe” dhe si e tillë është blerë nga SGA spa, që është një shoqëri italiane që funksionon dhe operon sipas legjislacionit italian, pasi nuk është e regjistruar në Shqipëri. SGA spa ka marrë pjesën e ashtuquajtur “*bad bank*” të bankave të Grupit Veneto Banca. Ankuesi pretendon se prona e tij e vendosur si kolateral pranë Veneto Bank sh.a. në Shqipëri, ka kaluar në favor të SGA spa, e cila ka kontraktuar Tranzit sh.p.k.(shoqëri shqiptare) të veprojë në emër të saj. Tranzit sh.p.k. ka patur si detyrë të njoftojë klientët, me qëllim që të paguajnë kreditë, që kanë marrë si financime pranë ish-Veneto Bank sh.a., tashmë e falimentuar.

Për sa më sipër ankuesi shprehet se ISPB nuk ka zbatuar Marrëveshjen Reciproke për Përfundimin e Kontratës së Punës të lidhur ndërmjet tij dhe përfaqësuesve të saj. Për këtë arsye, ankuesi thekson faktin se diskriminohet nga ISPB për shkak të “*përkatësisë në një grup të veçantë*”.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Pas analizimit të ankesës nr. 122, datë 27.09.2019, e Z. E.C., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B.** Mbështetur në nenin 33, pika 7³, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua me shkresën nr. 1473/1, datë 02.10.2019 Intesa San Paolo Bank (ISPB), ku kërkohej informacion, lidhur me situatën e parashtruar nga ankuesi. Shkresa e sipërpërmendur iu dërgua për dijeni edhe ankuesit.
 - 1.** Në përgjigje të shkresës së sipërpërmendur, Intesa San Paolo Bank (ISPB) dërgoi shkresën nr. 1473/2, datë 04.11.2019, nëpërmjet së cilës informon sipas nën çështjeve të cituara në shkresën nr.1473/1, datë 02.10.2019, të Komisionerit.

Në lidhje me pikën 1, të cituar në shkresën e KMD-së, Intesa San Paolo Bank (ISPB) ka dërguar kopje të Marrëveshjes Reciproke të lidhur ndërmjet Veneto Bank/Intesa San Paolo Bank dhe ankuesit E.C.;

³ Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: “*Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër*”.

Në lidhje me pikën 2, të cituar në shkresën e KMD-së, ku kërkohet informacion mbi arsyet e mos zbatimit të pikës 5 të Marrëveshjes së sipërpërmendur, që ta të bëjë me kredinë e ankuesit, ISPB sqaron se pika 5 e Marrëveshjes, në lidhje me procesin e pushimit kolektiv për punonjësit e Veneto Bank sh.a. të firmosur në prani të përfaqësuesve të Këshillit të Veneto Bank, të Ministrisë në cilësinë e Ndërmjetësuesit dhe të Intesa Sanpaolo Bank, Aneksi 2, parashikon: “Për punonjësit që janë subjekt i pushimit kolektiv dhe ata që do të nënshkruajnë Marrëveshjen Reciproke për Përfundimin e Marrëdhënies së Punës me Punëdhënësin, ISBA do të aplikojë për kreditë ekzistuese termat dhe dhe kushtet preferenciale që aktualisht janë në fuqi për stafin në ISBA”.

Kjo pikë nuk mund të zbatohet, sepse në datën 01.10.2018, kredia e z. E.C. nuk ka qenë në librat (pasqyrat) e Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a.

Në lidhje me pikën 3, të cituar në shkresën e KMD-së, ISBA sqaron se kjo bankë mbështetet në nenin 11, të Rregullores nr. 62, datë 14.09.2011, e Bankës së Shqipërisë, “Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja” (e ndryshuar), për të kryer vlerësimin e kredive të këqija. Kreditë e këqija janë klasat nënstandard, të dyshimta dhe të humbura, sikurse përcaktohet në Kreun III, nenin 11, pika 2/c,d,e, ku citohet:

“Vlerësimi i kredive të këqija dhe krijimi i fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve”

Neni 11 “Klasifikimi i kredive”

1. Bankat, bazuar në kushtet e përcaktuara në pikat 2 dhe 3 të këtij neni, bëjnë klasifikimin e kredisë çdo muaj, në një nga kategoritë e mëposhtme:

- a) “standarde”;*
- b) “në ndjekje”;*
- c) “nënstandarde”;*
- d) “të dyshimta”;*
- e) “të humbura”.*

2. Bankat, bazuar në ditëvonesat në shlyerjen e kredisë dhe gjendjen financiare të kredimarrësit, i klasifikojnë kreditë (duke përjashtuar kreditë kufi) si më poshtë:

a) “standarde”, kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

- i. gjendja financiare e kredimarrësit dhe flukset e pritshme hyrëse të parasë janë plotësisht të mjaftueshme për vazhdimësinë e veprimtarisë së tij dhe shlyerjen e detyrimeve,*
- ii. kryegjëja ose interesi nuk është paguar për një periudhë prej 1 (një) deri 30 (tridhjetë) ditësh nga data e pagesës së këstit;*

b) “në ndjekje”, kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

- i. gjendja financiare e kredimarrësit dhe flukset hyrëse të parasë janë të mjaftueshme për të përmbushur detyrimet, pavarësisht vështirësive financiare të momentit, dhe se nuk ka shenja përkeqësimi të gjendjes së kredimarrësit për të ardhmen,*

ii. kryegjëja ose interesi nuk është paguar për një periudhë prej 31 (tridhjetë e një) deri 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga data e pagesës së këstit;

c) “nënstandarde”, kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

i. gjendja financiare e kredimarrësit, kapitali dhe flukset hyrëse të parasë vlerësohen si të pamjaftueshme për përmbushjen e rregullt të detyrimeve të prapambetura, ose banka nuk disponon gjithë informacionin e kërkuar ose të përditësuar, të nevojshëm për të vlerësuar plotësisht gjendjen financiare të tij,

ii. kryegjëja ose interesi nuk është paguar për një periudhë prej 91 (nëntëdhjetë e një) deri 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditësh nga data e pagesës së këstit;

d) “të dyshimta”, kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

i. gjendja financiare e kredimarrësit, kapitali dhe flukset hyrëse të parasë vlerësohen si të pamjaftueshme për përmbushjen e plotë të detyrimeve, kredimarrësi shfaq probleme likuiditeti, dhe deklarimi i kredimarrësit “në paaftësi paguese/i falimentuar”, vlerësohet si një mundësi reale,

ii. kryegjëja ose interesi nuk është paguar për një periudhë prej 181 njëqind e tetëdhjetë e një) deri 365 (treqind e gjashtëdhjetë e pesë) ditësh nga data e pagesës së këstit;

e) “të humbura”, kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

i. gjendja financiare e kredimarrësit vlerësohet qartë se nuk siguron përmbushjen e plotë të kushteve të shlyerjes së kryegjësë dhe të interesit; ose vlerësohet se mungon i gjithë dokumentacioni i nevojshëm për përcaktimin e gjendjes financiare; ose kredimarrësi është në paaftësi paguese/ka falimentuar, është përfshirë në proces likuidimi; ose kredimarrësi ka vdekur dhe askush nuk mund të paguajë kredinë; ose banka ka depozituar te përmbartuesi gjyqësor kërkesën për fillimin e procesit të ekzekutimit të detyrueshëm të kolateralit, në rast se kredia është e siguar me kolateral; ose gjykata ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit, në rast se kredia nuk është e siguar me kolateral.

Përfundim nga kushti i fundit i kësaj pike bëjnë ato kredi, të cilat i janë nënshtruar procesit të ristrukturimit dhe plotësojnë kushtet e nenit 13, paragrafit 2, shkronja “a” dhe “b” të kësaj rregulloreje.

ii. kryegjëja ose interesi nuk është paguar për një periudhë prej më shumë se 365 (treqind e gjashtëdhjetë e pesë) ditësh nga data e pagesës së këstit.

.....

5. Në rastin kur kushtet e klasifikimit të kredive, të përcaktuara në pikat 2 ose 3 të këtij neni, plotësohen për kategori të ndryshme të klasifikimit të kredisë, bankat klasifikojnë kredinë në kategorinë më të ulët.

6. Bankat, për persona ose grup personash të lidhur, për të cilët është regjistruar më shumë se një ekspozim, bëjnë klasifikimin e kredive në një kategori të vetme, duke u bazuar në klasifikimin më të ulët ndërmjet klasifikimeve individuale.”

Në lidhje me pikën 4 të cituar në shkresën e Komisionerit, ISBA sqaron se kjo bankë nuk është përfshirë fare në analizën për klasifikimin si kredi e keqe, të kredisë së Z. E.C.. Kjo analizë është kryer

nga ana e Veneto Bank sh.a., pikërisht sepse kur kjo kredi u cilësua si e tillë dhe u transferua si e tillë tek Veneto Bank SpA në Itali, bashkimi me përthithje midis “Banka Veneto” sh.a. në Shqipëri dhe Bankës ISBA sh.a. nuk kishte ndodhur ende. Sipas marrëveshjes për Ri-Transferimin e Kredive, datë 04 gusht 2017, kredia e huamarrësit E.C. ishte klasifikuar tashmë si kredi e keqe në 26 qershor 2017. Lista e të gjithë huamarrësve me probleme në 26 qershor 2017 u përdor si referencë për “Transferimin” tek Veneto Bank SpA, subjekt i likujdimit të detyrueshëm administrativ, sikundër parashikohet në Marrëveshjen e Ri-Transferimit të Kredive, datë 04 gusht 2017. Zbatimi i kësaj kontrate u realizua në 29 dhjetor 2017 (datë, në të cilën kreditë me probleme që u shitën nuk rezultojnë më në librat e Veneto Banka sha), shumë kohë përpara fillimit të Projektit të Bashkimit midis Veneto Banka sh.a. dhe Intesa San Paolo sh.a.

Në lidhje me pikën 5 të cituar në shkresën e Komisionerit, ISBA sqaron se asnjë nga punonjësit që kanë nënshkruar Marrëveshjen Reciproke për përfundimin e Kontratës së Punës në datën e Bashkimit (1/10/2018) nuk ka patur asnjë kredi të keqe të përfshirë në portofolin e kredisë së trashëguar (nga ISBA sha) të ish Veneto Banka sha. Në fakt që prej datës 01.10.2018, Veneto Banka SpA, subjekt i Likujdimit të Detyrueshëm Administrativ ka blerë (marrë) nga Veneto Banka sha vetëm kreditë e këqija të përfshira në listën e lartpërmendur të Huamarrësve me probleme në datën 26 qershor 2017. Prandaj ISBA sot nuk ka të kualifikuar si Kredi të Keqe asnjë kredi që i është akorduar ish punonjësve të Veneto Banka sha, të cilët kanë nënshkruar Marrëveshjen Reciproke për Përfundimin e Kontratës së Punës.

Në lidhje me pikën 6 të cituar në shkresën e Komisionerit, ISBA sqaron se për të gjithë 33 punonjësit e ish-Veneto Banka, të cilët kanë nënshkruar Marrëveshjen Reciproke për Përfundimin e Kontratës së Punës dhe që kanë patur kredi në Datën e Bashkimit (01.10.2018), ISBA sh.a. ka aplikuar dhe vazhdon të aplikojë terma dhe kushte preferenciale që janë në fuqi për stafin e ISBA sha, ndërsa për ata punonjës që kanë patur kushte më të mira pune vazhdojnë të jenë në fuqi kushtet më të mira.

Në lidhje me pikën 7 të cituar në shkresën e Komisionerit, ISBA sqaron se Intesa Sanpaolo Bank Albania nuk e ka përthithur ish-Spa Veneto Banka SPA në Itali, e cila ende vazhdon të jetë një subjekt juridik ekzistues nën administrim të veçantë. ISBA thekson faktin se nuk ka dijeni, se cili është trajtimi që i është rezervuar punonjësve të këtij subjekti juridik. Intesa Sanpaolo Bank Albania nuk ka asnjë lidhje me atë që ka ndodhur në Itali për punonjësit e Veneto Banka Spa, subjekt i Likujdimit të Detyrueshëm Administrativ. ISBA nuk e disponon këtë informacion, pasi është një subjekt, që ushtron aktivitetin e saj mbështetur në legjisllacionin shqiptar dhe nuk ka qasje në informacione, që lidhen me punonjësit e Veneto Banka Spa në Itali, duke qenë dy subjekte të ndryshme juridike, të themeluara në vende të ndryshme dhe që nuk kanë asnjë lidhje midis tyre.

Në lidhje me pikën 8 të cituar në shkresën e Komisionerit, ISBA sqaron se sikundër është raportuar në 01.10.2018, data e bashkimit me përthithje e Veneto Banka sha nga Intesa Sanpaolo Bank Albania sha, kredia e Z. E.C. nuk rezultonte në librat (pasqyrat) e Veneto Banka sh.a. – Shqipëri dhe për këtë arsye ISBA nuk e ka informuar Z. E.C.. Në dijeninë e ISBA, Z. E.C. është informuar rregullisht në lidhje me Transferimin e detyrimeve të tij tek Veneto Banka Spa, subjekt i likujdimit të Detyrueshëm Administrativ (jo tek SGA Spa). ISBA thekson faktin se kredia e klientit klasifikohet si kredi me probleme dhe asnjë ligj apo rregullore nuk parashikon informimin e klientit nga ana e Bankës. Për

këtë arsye, ISBA nuk ka dijeni nëse z. E.C. është informuar zyrtarisht nga ana e Veneto Banka sha, pavarësisht faktit se ai ka qenë plotësisht i vetëdijshëm në lidhje me vonesën e gjatë për likuidimin e kredive dhe duke qenë punonjës i Bankës, ai është informuar në lidhje me rregulloret e zbatueshme në Shqipëri.

Në bazë të legjislacionit shqiptar për transferimin e kredive, njoftimi është detyrë e subjekteve që janë kreditore në momentin e transferimit të kredisë (“Banka Veneto” sha në Shqipëri dhe Veneto Banca SpA në Itali). Megjithatë në shkresën e ISBA theksohet fakti se dëshiron të informojë KMD-në se z. E.C. ka qenë në dijeni që kredia e tij ishte vlerësuar si kredi e keqe, fakt i cili është parashtruar në pretendimin e z. E.C. dhe dokumentohet gjithashtu në komunikime të ndryshme që z. E.C. i ka dërguar aksionerit Intesa Sanpaolo SpA.

Në lidhje me pikën 9 të cituar në shkresën e Komisionerit, ISBA sqaron se Z. E.C. ka hyrë në marrëdhënie pune me Veneto Banka sh.a. në datën 08.05.2006, duke lidhur një kontratë individuale pune, me afat të pacaktuar, në bazë të legjislacionit shqiptar. Banka Veneto ka qenë një shoqëri shqiptare e organizuar si shoqëri tregëtare dhe e regjistruar pranë QKB-së. Intesa Sanpaolo Bank Albania (“ISBA”) është një bankë shqiptare e organizuar si shoqëri tregëtare sipas legjislacionit shqiptar dhe siç rezulton nga ekstrakti tregëtar, lëshuar nga QKB zotërohet 100% nga banka italiane “Intesa Sanpaolo” SpA (“ISP”). Siç pranohet edhe nga Z. E.C., aksioneri i vetëm i ISBA, pra banka italiane Intesa Sanpaolo SpA (ISP), ka blerë në qershor të vitit 2017, për çmimin prej 1 euro, disa asete të bankës italiane Veneto Banca SpA, midis tyre edhe 100% aksionet e Banka Veneto sh.a. Blerja e aseteve të Veneto Banca SpA nga ana e ISP erdhi si pasojë e vendosjes në gjendje të likuidimit administrativ të detyruar të Veneto Banca SpA, e cila ishte rrjedhojë e mungesës së aftësisë paguese të kësaj të fundit. Gjendja e likuidimit administrativ të detyruar u vendos në mënyrë të jashtëzakonshme me anë të Dekret-ligjit nr. 99, datë 25.06.2017 “Dispozita urgjente në lidhje me likuidimin e detyrueshëm administrativ të Banca Popolare di Vicenza SpA dhe Veneto Banca SpA, publikuar në Fletoren Zyrtare të Republikës së Italisë Nr. 146, datë 15.06.2017. Sipas këtij Dekret Ligji, (neni 2), në bazë të miratimit të dhënë nga Komisioni Europian, autorizohej Ministri i Ekonomisë, që me propozim të Bankës së Italisë, të urdhëronte fillimin e procedurave të likuidimit të detyruar të subjekteve të mësipërme.

Në bazë të Dekret ligjit të sipërcituar (neni 3), likuidatorët e emëruar kanë të drejtë të cedojnë tek një ose disa subjekte të përzgjedhura, asete, pjesë asetesh, degë ndërmarrje, pasuri, të drejta apo marrëdhënie juridike, detyrime, pasive, aktive, në pjesë apo në grupe, të cilat i përkasin ndër të tjera edhe Veneto Banca SpA. Më tej, Dekret Ligji, në nenin 5 të tij, parashikon në mënyrë të drejtpërdrejtë që kreditë me probleme (të deterioruara, jo reformuese), si dhe çdo e drejtë apo aset i refuzuar apo i kthyer mbrapsht nga subjektet e përzgjedhura si më lart, do t’i jepen në cedim (nga Veneto Banca SpA, subjekt i Likuidimit të Detyrueshëm Administrativ) shoqërisë SGA (Società di Gestione Attività SpA), shoqëri kjo e kontrolluar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë së Republikës së Italisë.

- C. Në vijim të ndjekjes së procedurave të shqyrtimit administrativ, palët u njoftuan për seancë dëgjimore, e cila u vendos të realizohet **në datën 20.12.2019, ora 12:00**, pranë Zyrës së KMD-së.

Në seancë dëgjimore u paraqitën disa përfaqësues të Intesa San Paolo Bank sh.a., ankuesi i asistuar nga përfaqësuesi i tij ligjor, si dhe një përfaqësues i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Në seancë dëgjimore, ankuesi dhe përfaqësuesi i tij ligjor parashtruan pretendimet e tyre për qendrim të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë të Bankës Intesa Sanpaolo Albania, ndaj z. E.C. në cilësinë e ish-punonjësit kreditor të ish-Veneto Banka sh.a., bankë e cila ishte përthithur nga Banka Intesa Sanpaolo Albania. Ankuesi sqaroi se ai ka nënshkruar një Marrëveshjen Reciproke për Përfundimin e Kontratës së Punës me përfaqësues të ISBA, në bazë të së cilës, ndaj kredive të tij tek ish-Veneto Banka sh.a., do të aplikoheshin terma dhe kushte preferenciale, që janë në fuqi për stafin e ISBA sha. Ankuesi pretendoi për moszbatim të marrëveshjes së mësipërme nga Intesa San Paolo Banka Albania sh.a., e cila nuk kishte zbatuar parashikimin e mësipërm ndaj kredive të tij, të trashëguara nga ish-Veneto Banka sh.a. z. E.C dhe përfaqësuesi i tij ligjor u shpreh se nga moszbatimi i një parashikimi të tillë, përbën diskriminim për shkak të përkatësisë në një grup të veçantë. I pyetur se cili ishte grupi i veçantë, së cilit ankuesi i përkiste, ai u shpreh se bënte pjese në grupin e ish-punonjësve të ish-Veneto Banka sh.a., të cilët ishin larguar nga puna si pasojë e procesit shkrirjes së dy bankave dhe që kishin nënshkruar Marrëveshjen Reciproke për Përfundimin e Kontratës së Punës me përfaqësues të ISBA, e cila nuk ishte zbatuar për ta, në lidhje me kreditë që kanë patur tek ish-Veneto Banka sh.a. Përfaqësuesi ligjor i ankuesit u shpreh se çështja në lidhje me kreditë e z. E.C është bërë objekt shqyrtimi gjyqësor pranë gjykatës civile, si dhe kanë kryer kallëzim penal pranë organit të prokurorisë në lidhje me shkeljet e kryera.

Përfaqësuesit e ISBA u shprehën se nuk është depozituar asnjë njoftim që të provojë që ndaj bankës, që ata përfaqësojnë, të ketë filluar ndonjë procedim për ndjekje penale nga ana e organit të prokurorisë, por në proces ndodhet vetëm një çështje gjyqësore civile, objekti i së cilës është më i gjerë se konteksti i çështjes në shqyrtim pranë Komisionerit. Njëkohësisht, ata theksuan faktin se objekti i çështjes në gjykim pranë gjykatës civile nuk përfshinte çështjen e diskriminimit të ankuesit nga ana e ISBA, për shkakun e pretenduar në ankesë.

Sipas përfaqësuesve të Bankës Intesa Sanpaolo sh.a. ekziston një marrëveshje 2-palëshe ndërmjet dy bankave, e lidhur në shtator 2018. Kjo marrëveshje parashikon pushimin kolektiv të punonjësve të ish-Bankës Veneto sh.a. Në këtë kontekst janë patur parasysh dy momente, përkatësisht punonjësit dhe kreditë e tyre. Pas kryerjes së bashkimit me përthithje, që ndodhi në 30 shtator 2018, 33 punonjës të ish-Bankës Veneto sh.a. nëshkruan Marrëveshjen Reciproke për Përfundimin e Kontratës së Punës, ku ndër ta ishte edhe ankuesi E.C. Në kushtet kur, kredia e z. E.C. nuk ndodhej në pasqyrat financiare të Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a., pika 5 e Aneksit 1, të Marrëveshjes së mësipërme nuk është zbatuar për të, ndërkohë që të gjitha pikat e tjera të kësaj marrëveshjeje janë të zbatuara. E pyetur nëse z. E.C. ndodhej në kushte të njëjta me 32 punonjësit e tjerë, që kishin nënshkruar Marrëveshjen e sipërpërmendur, Drejtorja e Burimeve Njerëzore pranë kësaj banke u përgjigj se ankuesi ishte në kushte të njëjta me ta vetëm për sa i përket marrëdhënieve të punës, por jo kredisë.

Përfaqësuesit e ISBA u shprehën se Marrëveshja për transferimin e kredive me probleme nga Veneto Banka sh.a. për në Veneto Banca Spa (Itali) mban datën 4 gusht 2017. Kredia e z. E.C. është transferuar në Itali në dhjetor 2017 dhe ai duhet të ketë patur dijeni mbi një fakt të tillë. Pikërisht, në

kushtet kur kredia e tij është transferuar në datën 29 dhjetor 2017, për në Veneto Banca Spa, në pasqyrat financiare të Intesa Sanpaolo Banka Albania sh.a. nuk rezultonte si e tillë.

Nga 32 ish-punonjesisit e tjerë të ish-Veneto Banka sh.a. që nënshkruan Marrëveshjen Reciproke, 24 prej tyre nuk kishin kredi, ndërsa 8 ish-punonjës kanë kredi, të cilat aktualisht u janë nënshtruar kushteve preferenciale për punonjësit e ISBA-së. Kredia e z. E.C. nuk ka kaluar asnjëherë tek ISBA, por ka kaluar tek Veneto Banc Spa.

Në vijim, Z. E.C. u shpreh se Intesa San Paolo Bank është pjesë e Marrëveshjes për kalimin e kredive, nga Veneto Banka sh.a. drejt Veneto Bank Spa në Itali. Njëkohësisht ai u shpreh se edhe 3 persona të tjerë ndodhen në të njëjtat kushte me të, pasi kredia e tyre ka kaluar pranë Veneto Banc Spa dhe Intesa Sanpaolo Banka Albania sh.a. nuk ka zbatuar Marrëveshjen Reciproke. Z. E.C. sqaroi se kredia e tij ishte në proces ristrukturimi. Ankuesi u shpreh gjithashtu se gjatë intervistës së punës, ai ishte intervistuar nga drejtoresha e Burimeve Njerëzore të ISBA, të cilën e kishte bërë me dije se kishte kredi. Kjo e fundit u shpreh se gjatë intervistës ajo asistonte kolegen italiane.

Përfaqësuesit e Intesa Sanpaolo Banka Albania sh.a. u shprehën se në Marrëveshjen për kalimin e Kredive ka qenë palë Intesa Sanpaolo Banca Spa në Itali, dmth banka mëmë dhe jo Banka ISBA në Shqipëri. Nga përfaqësuesit e ISBA u theksua fakti se kjo bankë nuk ka trashëguar asnjë kredi me probleme nga Veneto Banka sh.a.

Përfaqësuesit e KMD-së kërkuan në përfundim të seancës nga përfaqësuesit e ISBA-së, informacion mbi kreditë e 2 ish-punonjësve të ish-Veneto Banka sh.a. të përmendur nga z. E.C, që ndodheshin në kushte të njëjta me të. Përfaqësuesit e ISBA-së sqarua se nuk kanë asnjë informacion për këta dy punonjës dhe këta të fundit nuk janë ankuar asnjëherë mbi një gjë të tillë.

1. Në vijim të seancës dëgjimore, Komisioneri iu drejtua nëpërmjet shkresës nr. 168, datë 28.01.2019, Bankës së Shqipërisë, ku kërkohet informacioni i mëposhtëm:

- Mbi bazën e të dhënave të Regjistrimit të Kredive, të jepet informacion mbi statusin e kredisë së z. E.C., tek ish-Veneto Bank sh.a.;
- Informacion mbi datën e saktë, në të cilën kreditë e ankuesit E.C., znj. B. Q. dhe znj. F. K., ish-punonjëse të ish-Veneto Bank sh.a., janë cilësuar të këqija dhe cilat janë arsyet, për të cilat këto kredi janë konsideruar të tilla;
- Informacion mbi datën, kur ankuesi ka marrë dijeni mbi faktin se, kredia e tij është konsideruar e keqe. Nëse disponohet, të dërgohet kopje e njoftimit përkatës, ose çdo lloj akti tjetër, nëpërmjet së cilit z. E.C. është vënë në dijeni të këtij fakti;
- Informacion mbi numrin e përgjithshëm të ish-punonjësve kreditorë të Veneto Bank sh.a., kredia e së cilëve është konsideruar e keqe dhe është përcjellë pranë Veneto Bank Spa, Itali, në likuidim të detyrueshëm;
- Informacion mbi datën e saktë, në të cilën kreditë e ankuesit E.C., znj. B. Q. dhe znj. F. K., ish-punonjëse të ish-Veneto Bank sh.a. janë përcjellë nga Veneto Bank sh.a. për tek Veneto Bank Spa. Kur kanë marrë dijeni personat e sipërpërmendur mbi një fakt të tillë? Të dërgohen kopje të njoftimit të tyre si dhe të Marrëveshjeve përkatëse ndërmjet dy bankave;

- Informacion mbi datën e saktë, kur ka hyrë në fuqi shkrirja e ish-Veneto Bank sh.a. dhe Intesa Sanpaolo Bank;
- Informacion mbi faktin, nëse Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a. ka patur dijeni mbi kreditë e këqija të ish-punonjësve të Veneto Bank sh.a., në kushtet kur u realizua përthithja e Veneto Bank sh.a. nga kjo bankë.

2. Në përgjigje të shkresës nr. 168, datë 28.01.2019, së Komisionerit, Banka e Shqipërisë dërgoi shkresën nr. 614/1, datë 07.02.2020, nëpërmjet së cilës informon, si më poshtë vijon:

- Mbi bazën e të dhënave të Regjistrit të kredive rezulton se të gjitha ekspozimet e z. E.C. me ish Bankën Veneto sh.a. të raportuara aktualisht janë të klasifikuara me statusin 4 “Kredi e Humbur”.

Banka e Shqipërisë thekson faktin se për qëllime të raportimit të të dhënave në Regjistrin e Kredive, statusi dhe klasifikimi i kredive realizohet në përputhje me përcaktimet e Rregullores Nr. 62/2011, e ndryshuar “Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja”.

- Banka e Shqipërisë informon lidhur me pikën 2, të shkresës së KMD-së, se duke qenë se rasti i z. E.C. është trajtuar edhe më herët nga ky institucion, disponohen të dhënat e nevojshme, mbi bazën e së cilave gjenerohet informacion nga Regjistri i kredive. Ndërkohë që, për të mundësuar gjenerimin e një informacioni të satë dhe të sigurtë nga Regjistri i kredive, për znj. B. Q. dhe znj. F. K., nevojiten gjeneralitetet e plota të tyre: Emër/Atësi/Mbiemër dhe Datëlindje.

Sipas të dhënave të raportuara në Regjistrin e Kredive, z. E.C. rezulton të jetë raportuar si kredi me probleme duke filluar nga data 31.07.2019, periudhë, e cila përkon me raportimin për herë të parë të të dhënave, të kredimarrësve të transferuar pranë AMCO, nga shoqëria Tranzit shpk.

Në mënyrë të përsëritur, Banka e Shqipërisë sjell në vëmendjen e KMD-së se për qëllime prudenciale, bankat mbështeten në kriteret e parashikuara në rregulloren e sipërpërmendur për klasifikimin e kredimarrësve të tyre. Mbështetur në përcaktimet në ligjin nr. 9662/2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), bankat janë të detyruara të hartojnë pasqyrat financiare në formën dhe përmbajtjen e përcaktuar nga ligji “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit. Në këtë kontekst, sqarohet se transferimi i huave është realizuar mbështetur në kategorizimin e kredive sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNFR).

- Lidhur me pikën 3, të informacionit të kërkuar nga KMD, Banka e Shqipërisë sqaron se nuk disponon informacion mbi datën, në të cilën z. E.C. ka marrë dijeni mbi faktin që kredia e tij është konsideruar me problem, pasi bankat nuk kanë asnjë detyrim të njoftojnë pranë autoritetit për këtë qëllim.

- Lidhur me pikën 4, të informacionit të kërkuar nga KMD, Banka e Shqipërisë informon se nuk disponon informacion se ç'pjesë e portofolit të transferuar përbën detyrime të ish-punonjësve të Bankës Veneto sh.a.
- Lidhur me pikën 5, të informacionit të kërkuar nga KMD, Banka e Shqipërisë informon se nënshkrimi i Marrëveshjes së Transferimit të Huave midis Veneto Banka Spa (Itali) në likuidim dhe Veneto Banka sh.a. në Shqipëri është realizuar në datën **04 gusht 2017**. Bazuar në këtë marrëveshje, të gjitha huatë me probleme deri në datë **26 qershor 2017** do të transferoheshin tek Veneto Banka Spa (Itali) në likuidim.

Në lidhje me njoftimin për kalimin e huave, Banka e Shqipërisë nuk disponon kopje të njoftimit të tyre, por në çdo rast ka kërkuar respektimin e dispozitave të Kodit Civil në rastin e kalimit të kredive.

- Lidhur me pikën 6, të informacionit të kërkuar nga KMD, Banka e Shqipërisë sqaron se me Vendim të Këshillit Mbikqyrës nr. 60, datë 06.09.2018, të Bankës së Shqipërisë është dhënë miratimi paraprak për bashkimin me përthithje të Bankës Intesa Sanpaolo Albania sh.a. me Veneto Banka sh.a. Kjo e fundit është ç' regjistruar nga regjistri tregëtar në datën 01.10.2018.
- Lidhur me pikën 7, të informacionit të kërkuar nga KMD, Banka e Shqipërisë informon se nuk disponon informacion mbi faktin nëse Intesa Sanpaolo Bank Albania ka patur dijeni mbi kreditë e këqija të ish-punonjësve të Bankës Veneto sh.a., në kushtet kur u realizua përthithja e Veneto Banka sh.a. nga kjo bankë, por sqaron se portofoli i kredive me probleme, ose potencialisht si i tillë i Veneto Banka sha, nuk ka qenë pjesë e transaksionit të bashkimit me përthithje të kësaj banke nga Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës nr. 122, datë 26.09.2019, e z. E.C., Komisioneri jep vlerësimin dhe gjykimin e tij, vetëm për ato çështje, të cilat bëjnë pjesë në kompetencat, që këtij institucioni, i atribuohen nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*".

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë.

Në ankesën nr. 122, datë 26.09.2019, e z. E.C., ku pretendohet për diskriminim për shkak të "*përkatësisë në një grup të veçantë*", nga ana e Intesa San Paolo Bank Albania.

Mbështetur në provat e administruara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës së sipërpërmendur rezulton se, Z. E.C. ka hyrë në marrëdhënie pune me ish-Veneto Banka sh.a. në datën 08.05.2006. Në referencë të kontratës individuale të punës, së datës 22.06.2016, të

nënshkruar ndërmjet palëve⁴ rezulton se pozicioni i fundit i punës, që ka mbajtur ankuesi pranë Veneto Banka sh.a. ka qenë specialist në Departamentin e Tregut dhe Produkteve, pozicion, të cilin e ka mbajtur deri në datën 19.10.2018⁵.

Punëdhënësi i ankuesit, Banka Veneto sh.a. ka qenë një shoqëri tregëtare, e regjistruar pranë QKB-së dhe që ka funksionuar sipas legjislacionit shqiptar për shoqëritë tregëtare. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a. (“ISBA”), e cila është një bankë shqiptare e organizuar si shoqëri tregëtare, që funksionon sipas legjislacionit shqiptar. Një fakt i tillë rezulton nga ekstrakti tregëtar, lëshuar nga QKB, e cila është depozituar në cilësi prove nga vetë kjo banke. Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a. zotërohet 100% nga banka italiane “Intesa Sanpaolo” SpA (“ISP”), e cila është aksioneri i vetëm i Intesa Sanpaolo Bank Albania.

Në muajin qershor të vitit 2017, Intesa Sanpaolo Spa ka blerë me çmimin prej 1 euro, disa asete të bankës italiane Veneto Banca SpA, midis tyre edhe 100% aksionet e Banka Veneto sh.a. Blerja e aseteve të Veneto Banca SpA nga ana e Intesa Sanpaolo Spa erdhi si pasojë e vendosjes në gjendje të likuidimit administrativ të detyruar të Veneto Banca SpA, e cila ishte rrjedhojë e mungesës së aftësisë pagueuse të kësaj të fundit. Gjendja e likuidimit administrativ të detyruar u vendos në mënyrë të jashtëzakonshme me anë të Dekret-ligjit italian nr. 99, datë 25.06.2017 “*Dispozita urgjente në lidhje me likuidimin e detyrueshëm administrativ të Banca Popolare di Vicenza SpA dhe Veneto Banca SpA*”, publikuar në Fletoren Zyrtare të Republikës së Italisë Nr. 146, datë 15.06.2017. Sipas nenit 2, të këtij Dekret Ligji, në bazë të miratimit të dhënë nga Komisioni Europian, autorizohet Ministri i Ekonomisë, që me propozim të Bankës së Italisë, të urdhëronte fillimin e procedurave të likuidimit të detyruar të subjekteve të mësipërme.

Mbështetur në nenin 3, të Dekret ligjit të sipërcituar (neni 3), likuidatorët e emëruar kanë të drejtë të cedojnë tek një ose disa subjekte të përzgjedhura, asete, pjesë asetesh, degë ndërmarrje, pasuri, të drejta apo marrëdhënie juridike, detyrime, pasive, aktive, në pjesë apo në grupe, të cilat i përkasin ndër të tjera edhe Veneto Banca SpA.

Në nenin 5, të Dekret Ligjit nr. 99, datë 25.06.2017, parashikohet shprehimisht që kreditë me probleme (të deteriuara, jo reformuese), si dhe çdo e drejtë apo aset i refuzuar, apo i kthyer mbrapsht nga subjektet e përzgjedhura si më lart, do t’i jepen në cedim nga Veneto Banca SpA, subjekt i Likuidimit të Detyrueshëm Administrativ, shoqërisë SGA⁶/AMCO, shoqëri kjo e kontrolluar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë së Republikës së Italisë.

Në datën 04.05.2018, Mbledhja e Jashtëzakonshme e Asamblesë së Veneto Banka sh.a. miratoi Projektbashkimin me përrthithje të Veneto Banka sh.a. në Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a. Për arsye ekonomike, teknike dhe strukturore, bashkimi me përrthithje kërkoi zbatimin e një plani ristrukturimi, që sollti si pasojë pushimin kolektiv të disa prej punonjësve të Veneto Banka sh.a.

⁴ Me “Palë” kuptohen përfaqësuesit e ish-Veneto Banka sh.a., në cilësinë e punëdhënësit dhe z. E. C. në cilësinë e punëmarrësit;

⁵ Ankuesi ka marrë njoftim nëpërmjet e-mailit të punës se ishte përfshirë në pushim kolektiv.

⁶ Societa di Gestione Attivita SpA.

Z. E.C. ishte një ndër punonjësit e ish-Bankës Veneto, që iu nënshtrua pushimit kolektiv, ndërkohë që, ishte kredimarrës tek kjo bankë.

Për sa më sipër, i ndodhur para pushimit kolektiv, pra tashmë i papunë, pas 12 vitesh që punonte pranë kësaj banke, si dhe në kushtet kur kishte ende kredi të pashlyera tek ish-Veneto Banka sh.a., e cila u bashkua me përthithje me Intesa Sanpaolo Albania sh.a., ankuesi pranoi të nënshkruante aktin Marrëveshje Reciproke për Përfundimin e Marrëdhënies të Punës, datë 13.09.2018, me ish-punëdhënësit e tij Veneto Banka sh.a, Veneto Banka Spa dhe me aprovimin e nënshkrimit të përfaqësuesit të Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a.

Marrëveshja në fjalë ishte rrjedhim i Marrëveshjes nr. 1319 Rep., Nr. 546 Kol., datë 01.08.2018, *“Në lidhje me procesin e pushimit kolektiv për punonjësit e Veneto Banka sh.a.”*, të nënshkruar ndërmjet punëdhënësit, përfaqësuesve të Këshillit të Punonjësve të Veneto Banka sh.a. dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në cilësinë e ndërmjetësuesit. Në këtë marrëveshje, palët ranë dakord, lidhur me ofrimin e një sërë bonusesh dhe lehtësish për ish-punonjësit e Veneto Banka sh.a., që do t’i nënshtroheshin pushimit kolektiv, si për sa i përket trajtimit financiar, ashtu edhe në lidhje me punësimin e tyre, apo shlyerjen e kredive ekzistuese, të marra tek Veneto Banka sh.a. Në kontekstin e çështjes në shqyrtim vlen të përmendet parashikimi në nenin 5, të Marrëveshjes nr. 1319 Rep., Nr. 546 Kol., datë 01.08.2018, ku citohet: *“Për punonjësit që janë subjekt i pushimit kolektiv dhe ata që do të nënshkruajnë Marrëveshjen Reciproke për Përfundimin e Marrëdhënies së Punës me Punëdhënësin, ISBA do të aplikojë për kreditë ekzistuese termat dhe kushtet preferenciale që aktualisht janë në fuqi për stafin e ISBA-së”*.

Mbështetur në parashikimet e Marrëveshjes nr. 1319 Rep., Nr. 546 Kol., datë 01.08.2018, *“Në lidhje me procesin e pushimit kolektiv për punonjësit e Veneto Banka sh.a.”*, të nënshkruar ndërmjet punëdhënësit, përfaqësuesve të Këshillit të Punonjësve të Veneto Banka sh.a. dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në cilësinë e ndërmjetësuesit, është hartuar Marrëveshja Reciproke për Përfundimin e Marrëdhënies të Punës. Disa prej ish-punonjësve të ish-Veneto Banka sh.a., të përfshirë në pushimin kolektiv, e nënshkruan këtë Marrëveshje, sikurse ankuesi E.C., për efekt të përfitimit të bonuseve të përcaktuara në të.

Në nenin 2, të Marrëveshjes Reciproke për Përfundimin e Marrëdhënies të Punës, datë 13.09.2018, të lidhur ndërmjet z. E.C. dhe përfaqësuesve të ish-Veneto Banka sh.a., Veneto Banka Spa dhe Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a. parashikohet shprehimisht: *“Sipas kontratës së punës dhe marrëveshjes në lidhje me procesin e pushimit kolektiv për punonjësit e Veneto Banka sh.a, dt. 1.08/2018 mes Punëdhënësit, Përfaqësuesve të Këshillit të Punonjësve të Veneto Banka sh.a. dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Punëdhënësi bie dakord të paguajë për Punonjës, një dëmshpërblim, që përbën një pagesë të vetme në shumën bruto prej LEK 1,170,000 (“Pagesë për përfundimin e marrëdhënies së punës”). Kjo shumë ka si qëllim të mbulojë çdo lloj shpërblimi për shkak të përfundimit të marrëdhënies së punës që Punëdhënësi ka vendosur t’i paguajë Punonjësit. Përveç kësaj shume, Punonjësit do t’i paguhen si më poshtë:*

- Paga deri në Datën e Përfundimit të Marrëdhënies së Punës sipas kontratës së punës;

- *Pushimet vjetore të grumbulluara dhe të papërdorura;*
- *Periudha e njoftimit paraprak nga data 22 tetor 2018 deri në 13 Dhjetor 2018) lek 230,455”;*
- *Shpërblimi për vjetërsi në punë, 6 paga bruto, i barabartë me shumën bruto Lek 819,534.*
- *dhe çdo shumë tjetër sipas Kodit të Punës.”*

Për sa më sipër, rezulton se detyrimi i sipërpërmendur është shlyer ndaj z. E.C..

Ndërkohë që, Marrëveshja Reciproke për Përfundimin e Marrëdhënieve të Punës, datë **13.09.2018**, përmbante gjithashtu edhe një parashikim tepër të rëndësishëm, lidhur me shlyerjen e kredive ekzistuese të punonjësve të ish-Veneto Banka sh.a., që sikurse e përmendëm më sipër, parashikohej edhe në Marrëveshjen nr. 1319 Rep., Nr. 546 Kol., datë 01.08.2018, “*Në lidhje me procesin e pushimit kolektiv për punonjësit e Veneto Banka sh.a.*”.

Neni 5, i Ankesit 2, të Marrëveshjes Reciproke për Përfundimin e Marrëdhënieve të Punës, datë 13.09.2018 parashikon: “*Për punonjësit që janë subjekt i pushimit kolektiv dhe ata që do të nënshkruajnë Marrëveshjen Reciproke për Përfundimin e Marrëdhënies së Punës me Punëdhënësin, ISBA do të aplikojë për kreditë ekzistuese termat dhe kushtet preferenciale që aktualisht janë në fuqi për stafin në ISBA*”.

Gjatë hetimit administrativ rezultoi se Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a. nuk e ka zbatuar këtë pikë të Marrëveshjes Reciproke.

Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a. sqaroi se ky parashikim nuk mund të zbatohet, sepse në datën **01.10.2018**, kredia e z. E.C. nuk ka qenë në librat (pasqyrat) e Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a. Data **01.10.2018** përkon edhe me datën e ç’rregjistrimit të Veneto Banka sh.a. nga regjistri tregëtar.

Sipas informacionit të dhënë me shkresë zyrtare, si dhe gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesit e Intesa Sanpaolo Bank janë shprehur se sipas Marrëveshjes për Ri-Tranferimin e Kredive, datë 04 gusht 2017, kredia e huamarrësit E.C. ishte klasifikuar tashmë si kredi e keqe në 26 qershor 2017. Lista e të gjithë huamarrësve me probleme në 26 qershor 2017 u përdor si referencë për “Transferimin” tek Veneto Bank SpA, subjekt i likuidimit të detyrueshëm administrativ, sikundër parashikohet në Marrëveshjen e Ri-Transferimit të Kredive, datë 04 gusht 2017. Zbatimi i kësaj kontrate u realizua në 29 dhjetor 2017 (datë, në të cilën kreditë me probleme që u shitën nuk rezultonin më në librat e Veneto Banka sha), shumë kohë përpara fillimit të Projektit të Bashkimit midis Veneto Banka sha dhe Intesa San Paolo sh.a.

Në seancë dëgjimore, ISBA sh.a. theksoi faktin se nuk kishte asnjë dëgjim, lidhur me kreditë e këqija të ish-punonjësve të Veneto Banka sh.a. të cilat ishin transferuar pranë bankës mëmë Veneto Banka Spa, pasi portofoli i kredive me probleme, ose potencialisht si i tillë i Veneto Banka sha, nuk ka qenë pjesë e transaksionit të bashkimit me përthithje të kësaj banke nga Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a. Kjo e fundit është konfirmuar zyrtarisht edhe nga Banka e Shqipërisë, e cila me Vendimin nr. 60, datë 06.09.2018, të Këshillit Mbikqyrës ka dhënë

miratimin paraprak për bashkimin me përrthithje të Bankës Intesa Sanpaolo Albania sh.a. me Veneto Banka sh.a.

Për sa më sipër, nënshkrimi i Marrëveshjes së Transferimit të Huave midis Veneto Banka Spa (Itali) në likuidim dhe Veneto Banka sh.a. në Shqipëri është realizuar në datën 04 gusht 2017. Bazuar në këtë marrëveshje, të gjitha huatë me probleme deri në datë 26 qershor 2017 do të transferoheshin tek Veneto Banka Spa (Itali) në likuidim. Referuar aktit Marrëveshje për Ri-Transferimin e Huave, të datës 04 Gusht 2017, të lidhur ndërmjet Veneto Banka sh.a. dhe Veneto Banca Spa, në likuidim administrativ të detyrueshëm rezulton se kreditë me probleme të Veneto Banka sh.a. janë transferuar pranë bankës mëmë, Veneto Spa. Intesa Sanpaolo Spa (Itali) është palë në një marrëveshjeje të tillë, gjë që vërteton faktin se kjo bankë ka patur dijeni mbi huatë, që kanë kaluar nga Veneto Banka sh.a. tek Veneto Banca Spa. Edhe Marrëveshja Shtesë e Marrëveshjes për Transferimin e Vazhdueshëm të Kredive (Ri-Transferimin), e datës 4 gusht 2017 midis Veneto Banka sh.a. dhe Veneto Banca Spa në likuidim administrativ të detyrueshëm është një marrëveshje, për të cilën Intesa Sanpaolo Banka rezulton të ketë dijeni dhe ka qenë palë nënshkruese e saj. Bashkëlidhur kësaj Marrëveshje shtesë ndodhet lista e kredive që transferohen nga Veneto Banka sh.a. tek Veneto Banca Spa. Në këtë listë rezulton edhe emri i z. E.C..

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon që, në kushtet kur banka mëmë, Intesa Sanpaolo Bank Spa Itali ka patur dijeni mbi kreditë me probleme të transferuara nga Veneto Banka sh.a. për në Veneto Banca Spa, atëherë edhe Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a, e cila zotërohet 100% nga ISB Spa, ka patur dijeni lidhur me këto kredi apo hua me probleme, që po transferoheshin.

Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a. ka patur dijeni paraprakisht mbi kreditë e z. E.C. dhe statusin e tyre. Parashikimi i nenit 5, Ankesi 2, të kësaj Marrëveshjeje ishte i pamundur të zbatohet në rastin e z. E.C., pasi kjo kredi nuk ka qenë pjesë e pasqyrave financiare të kësaj banke, në momentin e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, pra nga data 13 shtator 2018 e në vijim.

Në anën tjetër, Komisioneri konstatoi se edhe vetë z. E.C. gjithashtu ka patur dijeni mbi transferimin e kredive të tij nga Veneto bank sh.a. pranë Veneto Banca Spa, para se të nënshkruhet Marrëveshja Reciproke për Përfundimin e Marrëdhënieve të Punës e datës 13.09.2018. Z. E.C. ka theksuar faktin se Veneto Banka sh.a. nuk i ka dërguar njoftim zyrtar lidhur me transferimin e kredive të tij, pranë Veneto Banca Spa. Pavarësisht sa më sipër, rezulton se në datën 20 mars 2018, ai ka marrë dijeni me e-mail, se nuk i mund të lëshohen vërtetime për kreditë e tij, pasi këto kredi janë kaluar tek Veneto Banca Spa. Njëkohësisht, Komisioneri gjykon se në kushtet, kur z. E.C ka qenë punonjës i Veneto Banka sh.a., përgjatë muajit dhjetor 2017 e në vijim deri në momentin e ç'rregjistrimit të kësaj shoqërie tregëtare, ka patur dijeni të plotë lidhur me statusin e kredive të tij, si dhe në lidhje me proceset, që do të kalonte ish-Veneto Banka sh.a. dhe kreditë e tij të pashlyera.

Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se të dy palët, që kanë nënshkruar Marrëveshjen Reciproke të datës 13.09.2018, kanë patur dijeni mbi statusin e kredive të z. E.C., sikurse edhe

mbi faktin që këto kredi kanë qenë transferuar në dhjetor 2017, pranë Veneto Banca Spa dhe se pika 5, e Aneksit 2, të Marrëveshjes Reciproke nuk mund të ishte e zbatueshme.

Në interpretim të pikës 1, të nenit 7 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ku parashikohet: *1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim*”, Komisioneri gjykon se z. E.C. nuk është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë e disfavorizues nga ana e Intesa Sanpaolo Bank Albania.

Në mungesë të një qëndrimi të padrejtë, disfavorizues e të padrejtë, nuk mund të ketë diskriminim për shkakun e pretenduar nga ankuesi.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 12 - 14, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të z. E.C., për shkak të përkatësisë në një grup të veçantë, nga Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a..
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Robert GAJDA

KOMISIONERI

Fusha – Punesim
Shkak – Perkatesi ne nje grup te vecante